



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:154606

Datë: 17.01.2024

Numri i dokumentit: 05204088

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.578/2023

GJYKATA THEMELORE GJILAN Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtares së vetme gjykuese Mevlide Shabani, me bashkëpunatoren profesionale Albinë Velekinca Sadiku, ne çështjen penale kundër të pandehurit D. N. nga fshati P., Komuna e P., për shkak të veprës penale kanosja nga nenin 181 paragrafi 4, lidhur me para.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-ës), të cilin e përfaqëson av.R. L. nga Gjilani, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr...../2023 të datës 04.08.2023, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar mori dhe publikisht shpalli më dt.12.01.2024, ndërsa me datë 17.01.2024, hartoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri D. N., me pseudonimin "R.", nga babai T. dhe nëna T..., e gjinisë T., i lindur me datë, në fshatin P., ku edhe jeton (me vendqëndrim në shtetin e Z.), punëtor në Z., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i .. fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal, serb, shtetas i Republikës së Kosovës dhe i Rep. Së Serbisë.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë 24.06.2023 rreth orës 11.00h, në fshatin Pasjan, K.Partesh, i pandehuri, me dashje dhe me qëllim të shkakimit të frikës dhe ankthit dhe pasigurisë për jetë ka kanosur seriozisht të dëmtuarin D. P., me fjalë dhe me mjet të rrezikshëm –një shati dhe me një bidon me benzinë, në atë mënyrë që përderisa i dëmtuari ishte duke punuar në spërkatjen e arës së B. N., i pandehuri nga shtëpia e tij shkon dhe i kërkon të ndalonte duke e kanos me fjalët "nëse nuk e largon traktorin kam me ta kall", mirëpo i dëmtuari vazhdon të punojë me ç rast i pandehuri shkon tek shtëpia e tij dhe me një shati në dorën e majtë dhe në dorën e djathtë me një bidon me benzinë, kthehet, i afrohet të dëmtuarit dhe e kanos me fjalët "se nëse nuk ndalesh kam me të mbyt me shati dhe kam me ta kall traktorin", me ç rast edhe fillon të spërkatë traktorin me benzinë, me ç rast i dëmtuari nga frika lë

traktorin dhe fillon të ikë, që si pasojë e veprimeve të tij tek i dëmtuari ka shkaktuar frikë, ankth dhe pasiguri për jetë.

- me çka ka kryer veprën penale kanosja nga nenin 181 par.4 lidhur me par. 2 të KPRK-ës.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,38,39,40,42,43,44,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 242 dhe 364 të KPP-ës, të pandehurin e lartcekur:

E G J Y K O N

I.Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muaj**, ashtu që me propozimin dhe me pëlqimin e të pandehurit dhe në kuptim të nenit 44 të KPRK-së, të pandehurit D.N., dënimi i shqiptuar me burgim i **ZËVENDËSOHET** me dënim me gjobë në shumën prej **1000€ (njëmijë-euro)**, të cilën gjobë i njëjti është i obliguar ta paguajë me **tri këste** në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri i larte cekur, nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguajë dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet në dënim me burgim ashtu që 1 (një) ditë burgim do t'i llogaritet për çdo 20 euro, të dënimit me gjobë.

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet), si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë -euro) për kompensimin e viktimave të krimit, pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 14.07.2023, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr..../2023, kundër të pandehurit D. N. nga fshati P., Komuna e P., për shkak të veprës penale kanosja nga nenin 181 paragrafi 4, lidhur me para.2 të KPRK-ës.

Me datë 11.01.2024, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezentë prokurori i shtetit, Adnan Hajdari, i pandehuri D. N., si dhe mbrojtësi i tij av.R. L. i caktuar sipas detyrës zyrtare me ç 'rast pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i pandehuri i pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se nuk ka nevojë për sqarime shtesë ndërsa sa i përket fajësisë i njëjti deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, i vie keq dhe i kërkon falje të dëmtuarit ndërsa i premton gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris këtë vepër apo vepër tjetër penale, duke kërkuar që ti shqiptohet një dënim më i butë. me ç 'rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242 të KPP-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit dhe më pas seanca e shqyrtimit fillestar ka vazhduar me deklaratimet e palëve rreth dënimit.

Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezente palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenin 242 paragrafi 1 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezentë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: raporti i policis me nr.2023-CP-..., i dat.11.07.2023, deklarata e të pandehurit D. N. e dt.24.06 dhe 27.06.2023, deklarata e dëshmitarit L. S., e dat.29.06.2023, deklarata e dëshmitarit B. N. e dat.26.06.2023, të dhënat nga data baza e policisë, për të kaluarën kriminale tete pandehurit, raporti i oficerit M. S., fotografit nga vendi i ngjarje, si dhe shkresat e tjera të lëndës, gjithashtu gjykata me rastin e pranimi të fajësisë nga ana e të pandehurit gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartë cekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri D. N., e ka kryer veprën penale: kanosja nga nenin 181 paragrafi 4, lidhur me para.2 të KPRK-ës, si në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesës si dhe përgjegjësinë penale të tij ashtu që me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës, ashtu që gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale në të cilën përfshihet fakti se i njëjti ka qenë plotësisht i përgjegjshëm për veprimet e tija meqenëse i njëjti në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka lënguar nga ndonjë sëmundje mendore apo ndonjë sëmundje tjetër, faktin se i njëjti ka paraqit një shkallë të lartë të vetëdijes dhe dëshirës për ta kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtore, po ashtu me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh edhe pranimin e fajit nga ana e të pandehurit, faktin se i njëjti është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin si dhe rrethanat personale të tij.

Duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 72 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të KPRK-ës gjykata të pandehurit i shqiptoj dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor të paraparë si në nenin 73 të KPRK-ës, gjithnjë duke konsideruar se me dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurit mund të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale,

shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, neni 463 të KPP-së, gjykata nuk e ka udhëzuar të dëmtuarin për realizimin e një kërkesë të tillë pasi që i dëmtuari D. P., në seancën gjyqësore të datë 11.01.2024, është deklaruar se hekë dorë nga një kërkesë e tillë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 450 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzete - euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

**P.nr.578/2023,
me datë 17.01.2024**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Mevlide Shabani**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjiilan.